



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 19 mars 2015
Nr. ref.: RK779/15

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI64/14

Parashtrues

Afrim Nuredini

Vlerësim i kushtetutshmërisë së listës së punëtorëve me të drejtë të kompensimit, në pajtim me Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Ferizaj, C. nr. 340/2001, të 11 janarit 2002, me të cilin ishte aprovuar kërkesa për kompensim të pagave të papaguara të 572 punëtorëve të ndërmarrjes shoqërore të Fabrikës së Tubave të Çelikut IMK

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Afrim Nuredini (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), me banim në fshatin Sllatinë e Epërme.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi, në kërkesën e tij, në mënyrë eksplicite kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) “[...] *INICIMIN E LIGJSHMËRISË kundër Aktgjykimit të plotfuqishëm të Gjykatës Kushtetuese në Prishtinë KIO8/09 [...]*”, të 17 dhjetorit 2010.

Objekti i çështjes

3. Pretendimi i parashtruesit të kërkesës i është drejtuar Sindikatës së Fabrikës së Tubave të Çelikut IMK, sepse nuk e ka përfshirë emrin e tij në listën e punëtorëve me të drejtë në kompensim, në pajtim me Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Ferizaj, C. nr. 340/2001, të 11 janarit 2002, me të cilin është aprovuar kërkesa për kompensim të pagave të papaguara të 572 punëtorëve të ndërmarrjes shoqërore Fabrikës së Tubave të Çelikut IMK.
4. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e nenit 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) dhe kërkon “*Nga Gjykata Kushtetuese të marr aktgjykim qe edhe un si ish puntor te me jepet e drejta ne kompenzim dhe te kompenzohem aq sa me takon per nente vite ne baz te rroges qe e kam pas ne ate koh si ish puntor I ksaj ndërmarrje*”.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 4 prill 2014, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
7. Më 6 maj 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI64/14, caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin nr. KSH. KI64/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.
8. Më 27 maj 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës.
9. Më 15 shtator 2014, Kryetari, me Vendimin nr. GJR. KI64/14, zëvendësoi gjyqtarin raportues Robert Carolan me gjyqtarin Ivan Čukalović.
10. Më 11 shkurt 2015, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 19 shkurt 1990, parashtruesit të kërkesës i ndërpritet marrëdhënia e punës me ndërmarrjen shoqërore Fabrikën e Tubave të Çelikut, me arsyetimin se ai ka munguar nga puna për 5 (pesë) ditë pune pa ndërprerje. Ndërprerja e marrëdhënies së punës ishte bazuar në nenin 75, paragrafi 2, pika 3 të Ligjit mbi të drejtat themelore nga marrëdhënia e punës, Gazeta Zyrtare RSFJ nr. 60/89 (Vendimi nr. 1386).
12. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën me vetëm 3 (tri) faqe të përbërë nga: 1. Kërkesa për “[...] INICIMIN E LIGJSHMËRISË kundër Aktgjykimit të plotfuqishëm të Gjykatës Kushtetuese në Prishtinë, KIO8/09 [...]”; 2. Vendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës nr. 1386 të 19 shkurtit 1990.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

13. Parashtruesi i kërkesës pretendon se ai nuk ishte në listën e punëtorëve me të drejtë në kompensim, në pajtim me Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Ferizaj, C. nr. 340/2001, të 11 janarit 2002, me të cilin ishte aprovuar kërkesa për kompensim të pagave të papaguara të 572 punëtorëve të ndërmarrjes shoqërore Fabrikës së Tubave të Çelikut IMK. Parashtruesi i kërkesës pretendon se ai nuk ishte informuar për këtë pasi që ka qenë jashtë Kosovës.
14. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës pretendon se *“Shkelja e ligjit të punës konsideroj se asht bere sepse edhe un si ish puntor i ksaj ndermarrje kam te drejt ne kompenzim per ate para te cilat edhe ligjerisht me takojn”*.
15. Prandaj, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që *“[...] edhe une si ish puntor te me jepet e drejta ne kompenzim dhe te kompenzohem aq sa me takon per nente vite ne baz te rroges qe e kam pas ne ate koh si ish puntor I ksaj ndermarrje”*.

Pranueshmëria e kërkesës

16. Gjykata duhet së pari të vlerësojë nëse parashtruesi ka përmbushur kushtet e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
17. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, që parasheh:
“Individët janë autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”
18. Përveç kësaj, neni 47.2 i Ligjit gjithashtu parasheh:
“Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.
19. Përveç kësaj, rregulli 36 (1) (b) i Rregullores së punës, parasheh:

“Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse: janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me Ligj kundër vendimit ose kundër aktgjykimit të kundërshtuar”.

20. Në rastin konkret, kërkesa e parashtruesit i drejtohet Sindikatës së Fabrikës së Tubave të Çelikut IMK, sepse nuk e ka përfshirë emrin e tij në listën e punëtorëve me të drejtë në kompensim, në pajtim me Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Ferizaj, C. nr. 340/2001, të 11 janarit 2002, me të cilin ishte aprovuar kërkesa për kompensim të pagave të papaguara të 572 punëtorëve të ndërmarrjes shoqërore Fabrikës së Tubave të Çelikut IMK.
21. Gjykata thekson që parimi i subsidiaritetit kërkon që parashtruesi i kërkesës t'i shterojë të gjitha mundësitë procedurale në procedura të rregullta për ta parandaluar shkeljen e Kushtetutës, nëse ka, ose, për ta korrigjuar shkeljen e një të drejte themelore.
22. Arsytimi për rregullin e shterimit është që autoriteteve përkatëse, duke përfshirë gjykatat, t'iu ofrohet mundësia për të parandaluar ose për të korrigjuar shkeljen e pretenduar të Kushtetutës. Rregulli bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës siguron mjete efektive juridike kundër shkeljes së të drejtave kushtetuese. Ky është një aspekt i rëndësishëm i karakterit subsidiar të Kushtetutës (Shih, Aktvendimin për papranueshmëri, *Universiteti AAB-RIINVEST SH.P.K., Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës*, KI41/09, i 21 janarit 2010, dhe shih *mutatis mutandis*, *Selmouni kundër Francës*, Nr. 25 803/94, GJEDNJ, Vendimi i 28 korrikut 1999).
23. Parashtruesi i kërkesës nuk ka treguar nëse i ka shteruar të gjitha mjetet juridike dhe kushtetuese në dispozicion si kusht për dorëzimin e kërkesës së tij, siç parashihet me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 47.2 të Ligjit.
24. Nga kjo rrjedh se kërkesa është e papranueshme në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullat 36 (1) (b) dhe 56 (b) të Rregullores së punës, më 11 shkurt 2015, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Ivan Čukalović



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani